

PYETJEVE TË LËNDËVE SOCIOLOGJIKE PËR PROVIMIN E SHTETIT

Pyetja 1.

Cili element i kulturës, sipas Anthony Giddens-it, ka natyrë ideale më abstrakte?

- A) Kultura materiale
- B) Norma more
- C) Norma folkuej.
- D) Vlera kulturore

Pyetja 2.

Si karakterizohet në studimet sociologjike vlerësimi i kulturave sipas roleve që ato luajnë për funksionimin e shoqërisë së vet?

- A) Normë kulturore
- B) Relativizëm kulturor
- C) Simbol kulturor
- D) Vlerë kulturore

Pyetja 3.

Cili element i kulturës ndikon më shumë në funksionimin e strukturave shtetërore?

- A) Gjuha e folur
- B) Gjuha e shkruar
- C) Norma folkuej
- D) Simboli kulturor

Pyetja 4.

Cili koncept sociologjik shpreh larmitetin e një kulture?

- A) More
- B) Folkuej
- C) Subkulturë
- D) Etnocentrizëm

Pyetja 5.

Cili është karakterizimi që përdorin më dendur njerëzit me psikoza etnocentrike të skajshme për anëtarët e kulturave të tjera?

- A) Altruistë
- B) Barbarë
- C) Miqësorë
- D) Tolerantë

Pyetja 6.

Cili është karakterizimi që përdornin më dendur për veten e tyre popujt me psikoza etnocentrike të skajshme?

- A) Popull agresiv
- B) Popull barbar
- C) Popull i paaftë
- D) Popull i vërtetë

Pyetja 7.

Në cilin lloj shoqërie ka pasur më pak pabarazi ndërmjet anëtarëve?

- A) Shoqëritë agrare
- B) Shoqëritë e gjuetarëve dhe të mbledhësve të ushqimeve
- C) Shoqëritë pastorale
- D) Shoqëritë ose qytetërimet tradicionale

Pyetja 8.

Çfarë çmoheshin përgjithësisht më pak nga anëtarët e shoqërive të gjuetarëve dhe të mbledhësve të ushqimeve?

- A) Ceremonitë fetare
- B) Pasuritë materiale
- C) Përgatitja e maskave
- D) Realizimi i pikturave

Pyetja 9.

Cila formë e veprimtarisë ekonomike është mbizotëruese në vendet e “Botës së Tretë”?

- A) Bujqësia
- B) Industria e lehtë
- C) Industria e rëndë
- D) Zejtaria

Pyetja 10.

Në cilën pjesë të shoqërisë shqiptare tradicionale kanë qenë më ndikuese normat kulturore që përcaktonin ekzogami të skajshme fisnore në marrëdhëniet martesore?

- A) Në qytetet e mëdha
- B) Në fshatrat e Shqipërisë së Jugut
- C) Në fshatrat e Shqipërisë së Mesme
- D) Në fshatrat e Shqipërisë së Veriut

Pyetja 11.

Çfarë kultivoi me përparësi regjimi socialist totalitar në shtetin shqiptar përgjatë viteve 1945-1990?

- A) Mendësi e praktika me natyrë etnocentrike

- B) Mendësi e praktika me natyrë fisnore
- C) Mendësi e praktika me natyrë ksenocentrike
- D) Mendësi e praktika me natyrë patriarkale

Pyetja 12.

Çfarë ndryshimesh pësuan mendësitë e praktikat me natyrë etnocentrike të kultivuara nga regjimi socialist totalitar në Shqipëri përgjatë viteve 1945-1990?

- A) U dobësua shkallë-shkallë
- B) U gërshetuan me mendësi fisnore
- C) U përforcuan shkallë-shkallë
- D) U zhdukën plotësisht

Pyetja 13.

Cilat mendësi kanë qenë më të përhapura ndër emigrantët shqiptarë në fillim të viteve '90 të shekullit XX?

- A) Mendësitë me natyrë etnocentrike
- B) Mendësitë me natyrë krahinore
- C) Mendësitë me natyrë ksenocentrike
- D) Mendësitë me natyrë patriarkale

Pyetja 14.

Në cilin tip organizimi shtetëror përgjatë shekullit XX kanë pasur më pak ndikim mendësitë e praktikat me natyrë etnocentrike të skajshme?

- A) Në shtetet demokratike
- B) Në shtetet fashiste
- C) Në shtetet naziste
- D) Në shtetet socialiste

Pyetja 15.

Në cilat mjedise të shoqërisë tradicionale shqiptare vlera kulturore e mikpritjes realizonte më shumë funksione shoqërore të rëndësishme?

- A) Në qytetet e mëdhenj
- B) Në qytetet e vegjël
- C) Në fshatrat fushore të Shqipërisë së Mesme
- D) Në fshatrat malore të Shqipërisë së Veriut

Pyetja 16.

Sipas Faik Konicës, cila vlerë kulturore e dallon popullin shqiptar ndër shumë popuj të tjerë?

- A) Praktikizmi pragmatik
- B) Shpirti konkurrues

- C) Shpirti novator
- D) Toleranca fetare

Pyetja 17.

Sipas Lesli Wajtit, cili element i kulturës shënon fillimin e historisë së shoqërisë njerëzore, që e dallon shoqërinë nga bota e kafshëve?

- A) Kultura materiale
- B) Normat kulturore
- C) Simbolet kulturore
- D) Vlerat kulturore

Pyetja 18.

Në cilat pjesë të shoqërisë tradicionale shqiptare komunikimi simbolik çmohej përgjithësisht më shumë në jetën e përditshme?

- A) Në qytetet e mëdhenj
- B) Në fshatrat e Shqipërisë Jugore
- C) Në fshatrat e Shqipërisë së Mesme
- D) Në fshatrat e Shqipërisë Veriore

Pyetja 19.

Në cilin tip shoqërie simbolet kulturore përdoren më pak për të përcjellë mesazhe me përmbajtje fetare?

- A) Shoqëria primitive
- B) Shoqëria skllavopronare
- C) Shoqëria feudale
- D) Shoqëria moderne e shekullit XX

Pyetja 20.

Cilët njerëz janë përgjithësisht më të prirur të përjetojnë situata shoku kulturor?

- A) Emigrantët që kanë punuar e jetuar në disa vende
- B) Njerëzit e mirarsimuar në disa vende
- C) Njerëzit më pak të arsimuar që kanë jetuar brenda një sistemi kulturore
- D) Njerëzit që kanë shëtitur si turistë në shumë vende

Pyetja 21.

Si tejkalohehin në shoqërinë tradicionale shqiptare tabute që kishin të bënin me marrëdhëniet intime ndërmjet të rinjve?

- A) Njëpërmjet postimit të letrave
- B) Njëpërmjet ndihmës së miqve
- C) Njëpërmjet ndihmës së ndërmjetësve
- D) Njëpërmjet simboleve kulturore

Pyetja 22.

Në cilën periudhë të historisë së popullit shqiptar këngët atdhetare operonin me më shumë simbole kulturore?

- A) Në vitet 1847-1912
- B) Në vitet 1925-1939
- C) Në vitet 1945-1990
- D) Në vitet 1991-2011

Pyetja 23.

Cilin funksion kryesor realizojnë simbolet kulturore në komunikimet ndërmjet politikanëve?

- A) Saktësojnë kuptimin e fjalëve
- B) Shprehin emocionet vetjake të politikanëve
- C) Shprehin parapëlqimet vetjake të politikanëve
- D) Përcjellin kuptime evazive, kontradiktore për çështje delikate

Pyetja 24.

Pse në shoqërinë tradicionale shqiptare përdoren shumë simbole kulturore që përcillnin mesazhe me kuptime të sofistikuara?

- A) Kishte shumë norma kulturore ndaluese ose tabu.
- B) Shumica e shqiptarëve ishin të shëtitur në vende të ndryshme të botës.
- C) Shumica e shqiptarëve punonin në sektorin e bujqësisë.
- D) Vlera kulturore e mikpritjes ishte mjaft e përhapur ndër shqiptarët

Pyetja 25.

Si ndikon procesi i atomizimit social në shoqërinë moderne në ecurinë e formimit të simboleve kulturore?

- A) Nxit shtimin e numrit të simboleve me përdorim ndërkulturor
- B) Nxit shtimin e numrit të simboleve të përbotwzuar
- C) Nxit shtimin e numrit të simboleve me përdorim subkulturor
- D) Nxit shtimin e numrit të simboleve me përdorim në shkenca

Pyetja 26.

Cilët janë më të prirur të përshtaten në mënyrë konverguese në procesin e komunikimit simbolik?

- A) Anëtarët e grupeve fetare të ndryshme
- B) Anëtarët e grupeve kulturore të ndryshme
- C) Anëtarët e grupeve profesionale të ndryshme
- D) Anëtarët e grupeve parësore

Pyetja 27.

Në çfarë linje dhe kahje përshtaten në procesin e komunikimit simbolik nëpunësit e niveleve më të ulëta në bashkëpunimet e përditshme me nëpunësit e niveleve më të larta?

- A) Divergjencë rritëse
- B) Divergjencë zbritëse
- C) Konvergjencë rritëse
- D) Konvergjencë zbritëse

Pyetja 28.

Në çfarë linje dhe kahje përshtaten në procesin e komunikimit simbolik politikanët e niveleve të larta kur bëjnë fushatë elektorale me zgjedhësit?

- A) Divergjencë rritëse
- B) Divergjencë zbritëse
- C) Konvergjencë rritëse
- D) Konvergjencë zbritëse

Pyetja 29.

Në çfarë linje dhe kahje përshtaten prindërit në procesin e komunikimit simbolik me fëmijët e tyre të vegjël?

- A) Divergjencë rritëse
- B) Divergjencë zbritëse
- C) Konvergjencë rritëse
- D) Konvergjencë zbritëse

Pyetja 30.

Në çfarë linje dhe kahje përshtaten përgjithësisht nxënësit dhe studentët në komunikimin e tyre simbolik përkatësisht me mësuesit dhe pedagogët?

- A) Divergjencë rritëse
- B) Divergjencë zbritëse
- C) Konvergjencë rritëse
- D) Konvergjencë zbritëse

Pyetja 31.

Në çfarë linje dhe kahje i përshtaten njëri-tjetrit në procesin e komunikimit simbolik bashkëshortët shqiptarë që bashkëjetojnë në harmoni?

- A) Divergjencë rritëse
- B) Divergjencë zbritëse
- C) Konvergjencë rritëse
- D) Konvergjencë zbritëse

Pyetja 32.

Cili grupim njerëzish reagon përgjithësisht më butë ndaj dhunimit negativ të pritshmërive në procesin e komunikimit?

- A) Njerëzit analfabetë ose më pak të arsimuar
- B) Njerëzit më fanatikë nga pikëpamja fetare
- C) Njerëzit që kanë bërë jetë të mbyllur
- D) Njerëzit e mirëarsimuar që kanë jetuar në mjedise të kulturave të ndryshme

Pyetja 33.

Cili lloj simbolesh përbotëzohet me ritme më të shpejtë?

- A) Simbolet e krijuara nga letërsia artistike
- B) Simbolet e krijuara nga trupat teatrore
- C) Simbolet e krijuara nga grupet rinore të popujve të prapambetur
- D) Simbolet e krijuara në fushën e shkencave natyrore.

Pyetja 34.

Cilat simbole të krijuara nga lëvizjet shoqërore avangardiste përbotëzohen përgjithësisht më shpejt?

- A) Simbolet e krijuara nga lëvizjet shoqërore avangardiste të vendeve më të urbanizuara
- B) Simbolet kulturore të krijuara nga lëvizjet shoqërore avangardiste të vendeve më pak të urbanizuara të Afrikës.
- C) Simbolet kulturore të krijuara nga lëvizjet shoqërore avangardiste në vendet më pak të urbanizuara të Amerikës Jugore
- D) Simbolet kulturore të krijuara nga lëvizjet shoqërore avangardiste të krijuara në vendet më pak të urbanizuara të Azisë

Pyetja 35.

Në cilën periudhë të historisë së popullit shqiptar oxhaku simbolizonte familjet e mëdha të nderuara dhe me ndikim në zgjidhjen e problemeve shoqërore e politike?

- A) Periudha 1878-1912
- B) Periudha 1945-1967
- C) Periudha 1968-1990
- D) Periudha 1991-2012

Pyetja 36.

Cila nga ngjyrat në veshjen e nuseve të reja ka ndryshuar më shumë kuptimet simbolike përgjatë 100 viteve të fundit në shoqërinë shqiptare?

- A) Ngjyra e bardhë
- B) Ngjyra e blertë
- C) Ngjyra e kuqe

D) Ngjyra e zezë

Pyetja 37.

Cilat simbole të përbotëzuara përthyhen më pak në veçoritë e formimit shpirtëror të anëtarëve të kulturave të ndryshme?

- A) Simbolet e krijuara nga literatura artistike
- B) Simbolet e krijuara nga literatura historike
- C) Simbolet e krijuara nga literatura sociologjike
- D) Simbolet e krijuara nga literatura e shkencave natyrore

Pyetja 38.

Si karakterizohet në studimet sociologjike fakti që në vendet demokratike të stabilizuara hierarkia e autoveturave shpreh në një masë të konsiderueshme hierarkinë shoqërore?

- A) Difuzion kulturor
- B) Disfunsion problematik
- C) Funksion i fshehtë
- D) Funksion i hapur

Pyetja 39.

Në shoqërinë tradicionale shqiptare, cili element shprehte simbolikisht më qartë statusin shoqëror të gruas?

- A) Distanca që mban në procesin e komunikimit me të tjerët
- B) Mënyra e lëvizjes së duarve në procesin e komunikimit
- C) Ndryshimi i mimikës së fytyrës në procesin e komunikimit
- D) Ngjyra dhe moda e veshjeve që ajo përdorte

Pyetja 40.

Në cilin mjedis shoqëror janë më vepruese lidhjet fisnore?

- A) Në qytetet e mëdhenj të vendeve më të industrializuara
- B) Në qytetet e mëdhenj të vendeve më pak të industrializuara
- C) Në zonat fshatare të vendeve më të industrializuara
- D) Në zonat fshatare të vendeve më të prapambetura

Pyetja 41.

Sipas Anthony Giddens-it, në cilën formë grupimi shoqëror përdoren fjalë që tregojnë më shumë afrimitet ndërmjet njerëzve se sa ata janë në të vërtetë?

- A) Klasë shoqërore
- B) Organizim klanor
- C) Nën klasë shoqërore
- D) Shtresë shoqërore

Pyetja 42.

Cili tip familje është më i përhapur në shoqërinë shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore?

- A) Familja bërthamë
- B) Familja feudale
- C) Familja e zgjeruar
- D) Familja patriarkale

Pyetja 43.

Si quhet martesë e një burri njëkohësisht me dy ose më shumë gra?

- A) Ekzogami
- B) Poliandri
- C) Poligini
- D) Policentrizëm

Pyetja 44.

Si quhet martesë e një gruaje me dy ose më shumë burra në të njëjtën kohë?

- A) Ekzogami
- B) Poliandri
- C) Policentrizëm
- D) Poligini

Pyetja 45.

Si quhet martesë që e lejon burrin ose gruan të ketë përkatësisht dy ose më shumë gra ose burra në të njëjtën kohë?

- A) Poliandri
- B) Poligami
- C) Poligini
- D) Policentrizëm

Pyetja 46.

Sipas George Murdoch, në cilin lloj shoqërie është më e përhapur poliandria?

- A) Në shoqëritë më të industrializuara
- B) Në shoqëritë më të urbanizuara
- C) Në shoqëritë skajshmërisht të pasura
- D) Në shoqëritë skajshmërisht të varfra

Pyetja 47.

Sipas Anthony Giddens-it, në cilën lloj familje ka sistem të përshkallëzuar hierarkie ndërmjet bashkëshorteve të një burri?

- A) Familja bërthamë
- B) Familja patriarkale
- C) Familja poligjene
- D) Familja e zgjeruar

Pyetja 48.

Cili ishte faktori kryesor që përcaktonte shumicën e lidhjeve martesore ndërmjet bashkëshortëve në shoqëritë tradicionale paraindustriale?

- A) Dashuria e ndërsjellë
- B) Interesat arsimore
- C) Interesat artistike
- D) Interesat socioekonomike

Pyetja 49.

Nga se përcaktohej shumica e rimartesave në shoqëritë mesjetare europianoperëndimore?

- A) Nga divorcet e shumtë
- B) Nga traditat fetare
- C) Nga traditat kulturore
- D) Nga vdekja e njërit prej bashkëshortëve

Pyetja 50.

Sipas Lawrence Stone-s, cila nga format e poshtëshënuara të familjes ka qenë përhapur masivisht më herët në historinë e Europës Perëndimore?

- A) Familja bërthamë e mbyllur
- B) Familja me prejardhje të hapur
- C) Familja me një prind
- D) Familja patriarkale e kufizuar

Pyetja 51.

Cila formë e familjes është më e përhapur në shoqëritë industriale të ditëve tona?

- A) Familja bërthamë e mbyllur
- B) Familja me prejardhje të hapur
- C) Familja me prindër homoseksualë
- D) Familje patriarkale e kufizuar

Pyetja 52.

Cila formë e familjes po përhapet më shpejt në shoqëritë e prapambetura të vendeve aziatike dhe afrikane?

- A) Familja bërthamë e mbyllur

- B) Familja me prejardhje të hapur
- C) Familja me prindër homoseksualë
- D) Familje patriarkale e kufizuar

Pyetja 53.

Në cilat mjedise socialkulturore të shoqërisë shqiptare të ditëve tona divorci përgjithësisht reflektohet në rrethe më të gjera shoqërore të bashkëshortëve të divorcuar?

- A) Në qytetet e mëdhenj
- B) Në qytetet e vegjël
- C) Në zonat fshatare të Jugut
- D) Në zonat fshatare të Veriut

Pyetja 54.

Cilat probleme janë më shqetësuese për shumicën e grave të divorcuara në shoqërinë shqiptare të ditëve tona?

- A) Problemet emocionale
- B) Problemet ekonomike
- C) Problemet politike
- D) Problemet shoqërore

Pyetja 55.

Sipas Anthony Giddens-it , çfarë ndjenje provojnë shumica e partnereve në çastet e para pas divorcimit?

- A) Anxetë
- B) Eufori
- C) Gëzim
- D) Vetërealizim

Pyetja 56.

Sipas studiuësve Judith Wollarstein dhe Joan Kelly, fëmijët e cilës grup-moshë priren më shumë të fajësojnë veten për divorcimin e prindërve të tyre?

- A) Fëmijët e kopshteve
- B) Fëmijët e klasave I-III
- C) Fëmijët e klasave IV-VI
- D) Fëmijët e klasave VII-IX

Pyetja 57.

Sipas Anthony Giddens-it, cili është shkaku kryesor që përcakton shumicën e familjeve me një prind në vendet perëndimore?

- A) Aksidentimi i njërit prej bashkëshortëve
- B) Divorcimi i bashkëshortëve

- C) Emigrimi i njërit prej bashkëshortëve
- D) Vdekja natyrale e njërit prej bashkëshortëve

Pyetja 58.

Në cilin grupim shoqëror është më i përhapur abuzimi seksual me fëmijët në shoqëritë më të industrializuara të dy dhjetëvjeçarëve të fundit?

- A) Në klasën e lartë
- B) Në klasën e ulët
- C) Në shtresën e lartë të klasës së mesme
- D) Në shtresën e mesme të klasës së mesme

Pyetja 59.

Cilat forma lëvizjesh shoqërore luajtën rol më të rëndësishëm për të tërhequr vëmendjen e publikut rreth çështjes së abuzimeve seksuale me fëmijët?

- A) Lëvizjet feministe në vendet më të industrializuara
- B) Lëvizjet e studentëve të viteve 1968-1970
- C) Lëvizjet për të drejtat e njeriut.
- D) Lëvizjet për të drejtat e zezakëve.

Pyetja 60.

Çfarë është incesti?

- A) Marrëdhënie seksuale ndërmjet një mashkulli dhe një femre të panjohur
- B) Marrëdhënie seksuale ndërmjet një mashkulli të bardhë dhe një gruaje zezake
- C) Marrëdhënie seksuale ndërmjet partnerëve me përkatësi fetare të ndryshme
- D) Marrëdhënie seksuale ndërmjet partnerëve me afri gjaku

Pyetja 61.

Cila formë e dhunës është disi më e toleruar nga opinioni i shoqërive bashkëkohore më të urbanizuara?

- A) Dhuna e babait ndaj fëmijëve të vegjël në mjedisin familjar
- B) Dhuna e babait ndaj fëmijëve të vegjël në mjedisin publik
- C) Dhuna e burrit ndaj bashkëshortes në mjedisin familjar
- D) Dhuna e gruas ndaj bashkëshortit në mjedisin publik

Pyetja 62.

Cila formë e dhunës është disi më e toleruar nga opinioni i shoqërive bashkëkohore më të urbanizuara?

- A) Dhuna e nënës ndaj fëmijëve të vegjël në mjedisin familjar
- B) Dhuna e nënës ndaj fëmijëve të vegjël në mjedisin publik
- C) Dhuna e vëllait ndaj motrave në mjedisin familjar
- D) Dhuna e vëllait ndaj motrave në mjedisin publik

Pyetja 63.

Sipas Anthony Giddens-it, nga cila vlerë kulturore perëndimore synonte t'i largonte anëtarët organizimi i kibbutseve nw fillimet e veta?

- A) Atdhetaria
- B) Humanizimi
- C) Shpirti konkurrues
- D) Shpirti praktik

Pyetja 64.

Në cilin vend është më e lartë përqindja e çifteve që bashkëjetojnë në ditët tona?

- A) Britania e Madhe
- B) Itali
- C) Spanjë
- D) Suedi

Pyetja 65.

Në cilin tip mjedisi shoqëror është më e përhapur bashkëjetesa e çifteve në ditët tona?

- A) Në mjedise fshatare me lidhje të forta fisnore
- B) Në mjedise fshatare ku është i fortë ndikimi i fesë katolike
- C) Në mjedise urbane ku është i fortë ndikimi i fesë katolike
- D) Në mjedise urbane ku është më e pranishme dukuria e atomizimit shoqëror

Pyetja 66.

Si quhet në studimet sociologjike procesi me anën e të cilit fëmija bëhet gradualisht i vetëdijshëm, i ditur, i aftë të kuptojë kulturën në të cilën ai ka lindur?

- A) Efekt hauthorne
- B) Efekt matheu
- C) Inovacion
- D) Shoqërizim

Pyetja 67.

Çfarë lloj reagimi është të qeshurit e fëmijës së vogël?

- A) Reagim i lindur
- B) Reagim i mësuar nga nëna
- C) Reagim i mësuar nga babai
- D) Reagim i nxitur nga një fëmijë tjetër që qesh

Pyetja 68.

Sa muaj pas lindjes fëmija fillon të mbajë në mendje njëfarë imazhi të nënës së vet?

- A) Katër muaj pas lindjes
- B) Shtatë muaj pas lindjes
- C) Dhjetë muaj pas lindjes
- D) Trembëdhjetë muaj pas lindjes

Pyetja 69.

Sipas studimeve të Selma Fraiberg për shoqërizimin, sa muajsh fëmija fillon të kuptojë se objektet ekzistojnë?

- A) 4-5 muajshe
- B) 6-7 muajshe
- C) 8-9 muajshe
- D) 10-11 muajshe

Pyetja 70.

Sipas studimeve të Mildred Patern për shoqërizimin, në cilën moshë fëmija fillon të përfshihet në lojën bashkëpunuese me fëmijët e tjerë:

- A) 2 vjeç
- B) 3 vjeç
- C) 4 vjeç
- D) 5 vjeç

Pyetja 71.

Sipas studimeve sociologjike mbi shoqërizimin, sa vjeç fëmijët fillojnë të shfaqin shqetësime për herë të parë kur prindërit nevríkosen me njëri-tjetrin?

- A) 2 vjeç
- B) 3 vjeç
- C) 4 vjeç
- D) 5 vjeç

Pyetja 72.

Sipas Anthony Giddens-it, cili është momenti kyç në procesin kompleks të shoqërizimit të fëmijëve?

- A) Dashuria e nënës në foshnjëri
- B) Formimi i hershëm i lidhjeve afatgjata me njerëz të tjerë
- C) Kontaktet e shpeshta me babain në fëmijëri
- D) Kontaktet e shpeshta me nënën në foshnjëri

Pyetja 73.

Cili nga studiuesit ka analizuar më me përparësi mënyrën se si fëmijët në procesin e shoqërizimit mësojnë të përdorin konceptet “unë” dhe “mua”?

- A) George Herbert Mead
- B) Harry Harloë
- C) Mildred Parten
- D) Sigmund Freud

Pyetja 74.

Sipas Sigmund Freud-it, në cilën moshë shumica e fëmijëve janë të aftë të heqin dorë nga shoqëria e vazhdueshme e prindërve të tyre dhe të hyjnë në një botë më të gjerë shoqërore?

- A) 2-3 vjeç
- B) 4-5 vjeç
- C) 6-7 vjeç
- D) 8-9 vjeç

Pyetja 75.

Cili nga studiuesit e poshtëshënuar i ka bazuar përfundimet e tij për shoqërizimin në studimet e drejtpërdrejta të modeleve të sjelljes së fëmijëve dhe adoleshentëve?

- A) Emile Dyrkheim
- B) George Herbert Mead
- C) Jean Piaget
- D) Sigmund Freud

Pyetja 76.

Sipas studimeve të Jean Piaget, në cilën periudhë të procesit të shoqërizimit fëmijët zotërojnë nocionet abstrakte, logjike?

- A) Periudha paravepruese
- B) Periudha sensorimotore
- C) Periudha vepruese formale
- D) Periudha vepruese konkrete

Pyetja 77.

Sipas studimeve të Jean Piaget, në cilën fazë të procesit të shoqërizimit fëmijët janë më egocentrikë?

- A) Periudha paravepruese
- B) Periudha sensorimotore
- C) Periudha vepruese formale
- D) Periudha vepruese konkrete

Pyetja 78.

Cila formë e punësimit ndikon më shumë në rritjen e prestigjit të grave në shoqërinë shqiptare të ditëve tona?

- A) Punësimi në ekonominë familjare pronë e bashkëshortit
- B) Punësimi në ekonominë private pronë e prindërve të saj
- C) Punësimi në ekonominë private pronë e të afërmeve të bashkëshortit
- D) Punësimi në sektorin publik

Pyetja 79.

Cili është motivi kryesor që i nxit vajzat dhe gratë të mirarsimohen në shoqërinë shqiptare të ditëve tona, sipas librit “Gratë në syrin e ciklonit të sfidave dhe perspektivave”?

- A) Afirmimi i prestigjit në shoqëri
- B) Dëshira për të emigruar
- C) Pasurimi sa më i shpejtë
- D) Sigurimi i një jetese shumë të rehatshme

Pyetja 80.

Në cilat vende është më e ulët shkalla e të vetëpunësuarëve në ditët tona?

- A) Në vendet më të industrializuara të Perëndimit
- B) Në vendet më të prapambetura bujqësore të Afrikës
- C) Në vendet më të prapambetura bujqësore të Amerikës Latine
- D) Në vendet ish-socialiste në tranzicion

Pyetja 81.

Si ka ndikuar përgjithësisht në jetën e grave shqiptare vetëpunësimi në ekonominë familjare?

- A) Ka dobësuar statusin e tyre ekonomik në shoqëri
- B) Ka përfaqësuar statusin e tyre ekonomik në shoqëri
- C) Ka rritur prestigjin e tyre në shoqëri
- D) Ka rritur mundësitë e tyre për t’u integruar në shoqëri

Pyetja 82.

Si ndikojnë përgjithësisht në marrëdhëniet martesore ndryshimet e statuseve të bashkëshortëve në periudha tranzicioni?

- A) Pakësojnë mundësinë për divorce
- B) Përmirësojnë komunikimin ndërmjet bashkëshortëve
- C) Rrisin shkallën e harmonisë ndërmjet bashkëshortëve
- D) Rrisin mundësitë për divorce

Pyetja 83.

Si ndikon rritja e shkallës së atomizmit të shoqërisë në vendet më të industrializuara në ecurinë e marrëdhënieve ndërmjet anëtarëve të familjes?

- A) Forcon marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve
- B) Forcon marrëdhëniet ndërmjet vëllezërve dhe motrave
- C) Forcon marrëdhëniet ndërmjet vëllezërve
- D) Rrit mundësit për divorce

Pyetja 84.

Në cilën linjë zbatoheshin më me korrektësi normat e ekzogamisë së skajshme në marrëdhëniet martesore në shoqërinë shqiptare tradicionale?

- A) Në linjë fisi
- B) Në linjë grupi fetar
- C) Në linjë klase shoqërore
- D) Në linjë shtrese shoqërore

Pyetja 85.

Si imponohet zbatimi i normave kulturore të ekzogamisë së skajshme në linjë fisnore ndër banorët e krahinave veriore të shoqërisë tradicionale shqiptare?

- A) Nëpërmjet organeve të drejtësisë
- B) Nëpërmjet organeve policore
- C) Nëpërmjet organizatave shoqërore
- D) Nëpërmjet opinionit të bazuar në normat kulturore

Pyetja 86.

Si ndikojnë normat kulturore të ekzogamisë në dinamikën e marrëdhënieve ndërmjet fiseve në shoqërinë tradicionale shqiptare?

- A) Rrisin mundësitë për konflikte ekonomike ndërmjet fiseve
- B) Rrisin mundësitë për mosmarrëveshje shoqërore ndërmjet fiseve
- C) Rrisin mundësitë për gjakmarrje ndërmjet fiseve
- D) Rrisin mundësitë për tejkalimin e konflikteve ndërmjet fiseve

Pyetja 87.

Si paraqitet në opinionin mbizotërues të shoqërisë tradicionale shqiptare martesat ndërmjet të rinjve dhe të rejave?

- A) Shprehje e dashurisë ndërmjet djalit dhe vajzës
- B) Respekti i vajzës për djalin
- C) Respekti i djalit për vajzën
- D) Aleancë ndërmjet fisit të vajzës dhe fisit të djalit

Pyetja 88.

Në cilin material të shkruar normat e ekzogamisë në linjë fisnore janë më të skajshme?

- A) Kanuni i Lek Dukagjinit
- B) Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare (1938-1939)
- C) Kodi i Familjes i shtetit shqiptar në vitet 1965-1990
- D) Kodi i Familjes në fuqi në Republikën e Shqipërisë

Pyetja 89.

Si reagonte shoqëria tradicionale shqiptare ndaj personave që bashkëjetonin pa kurorë martesë?

- A) Ishte indiferente
- B) I përfliste lehtë
- C) I dhunonte fizikisht
- D) I izolonte në masë të konsiderueshme

Pyetja 90.

Si quhen në studimet sociologjike konceptet e përgjithshme, kriteret në bazë të të cilave anëtarët e një kulturore përcaktojnë se çfarë është e dëshirueshme ose e padëshirueshme, e mirë ose e keqe, e bukur ose e shëmtuar?

- A) Norma kulturore
- B) Simbole kulturore
- C) Shok kulturor
- D) Vlera kulturore

Pyetja 91.

Cili faktor ndikonte më shumë në brendësimin e vlerës kulturore të besës në vetëdijen e shqiptarëve të shoqërisë tradicionale që banonin në krahinat malore më të thella?

- A) Forca e opinionit shoqëror
- B) Organet e pushtetit qendror
- C) Organet e pushtetit vendor
- D) Shkollat në gjuhë të huaja

Pyetja 92.

Në cilën periudhë të historisë së shoqërisë shqiptare miku në rolin e nëpunësit kryente më shumë funksione shoqërore?

- A) Në vitet 1878-1912
- B) Në vitet 1944-1967
- C) Në vitet 1968-1990
- D) Në vitet 1991-2011

Pyetja 93.

Në cilat shoqëri ka qenë përgjithësisht më e përhapur vlera kulturore e shpirtit konkurrues në periudhën moderne të historisë?

- A) Në shoqëritë më të prapambetura të Afrikës
- B) Në shoqëritë më pak të urbanizuara të Azisë
- C) Në shoqëritë më agrare të Amerikës Latine
- D) Në shoqëritë më të urbanizuara të Europës Perëndimore

Pyetja 94.

Në cilën situatë psikosociale shfaqet përgjithësisht më veprues profili altruist i formimit shpirtëror të shqiptarëve?

- A) Kur të afërmit, miqtë ose bashkëpunëtorët përjetojnë gëzim
- B) Kur të afërmit, miqtë ose bashkëpunëtorët përjetojnë hidhërim
- C) Kur të afërmit, miqtë ose bashkëpunëtorët janë në punët e përditshme
- D) Kur të afërmit, miqtë ose bashkëpunëtorët janë në kohën e paspunës

Pyetja 95.

Si quhet vlerësimi dhe gjykimi i kulturave të tjera sipas kritereve, standardeve të kulturës vetjake?

- A) Dinominejshën
- B) Eklesi
- C) Etnocentrizëm
- D) Ksenocentrizëm

Pyetja 96.

Si quhet parapëlqimi i kulturave të tjera në krahasim me kulturën vetjake?

- A) Eklesi
- B) Etnocentrizëm
- C) Ksenocentrizëm
- D) Kult

Pyetja 97.

Çfarë ndikimesh kanë pasur në shoqërinë shqiptare përpjekjet e rilindësve tanë të mëdhenj për të kultivuar mendësi me natyrë etnocentrike?

- A) Kanë përforcuar tiparet e subkulturave të shoqërisë shqiptare
- B) Kanë përforcuar prirjen e atomizmit të shoqërisë shqiptare
- C) Kanë përforcuar frymën e atdhetarisë ndër shqiptarët
- D) Kanë zbehur frymën e atdhetarisë ndër shqiptarët

Pyetja 98.

Në cilat rrethana kultivimi i mendësive etnocentrike realizon funksione socialkulturore pozitive?

- A) Kur popujt numerikisht të mëdhenj arrijnë nivel të lartë zhvillimi industrial
- B) Kur popujt numerikisht të vegjël arrijnë nivel të lartë zhvillimi shkencor
- C) Kur popujt numerikisht të mëdhenj janë ekonomikisht më të prapambetur
- D) Kur popujt e vegjël kërcënohen nga rreziku i çkombëtarizimit ose i zhdukjes

Pyetja 99.

Sipas William Sammer-it, si quhen normat kulturore që luajnë rol të rëndësishëm në funksionimin e shoqërisë?

- A) Etnocentrizëm
- B) Folkuej
- C) More
- D) Nënkulturë

Pyetja 100.

Sipas William Summer-it, si quhen normat kulturore më pak të rëndësishme për funksionimin e shoqërisë?

- A) Etnocentrizëm
- B) Folkuej
- C) More
- D) Nënkulturë

Pyetja 101.

Cila metodë është më e përshtatshme për realizimin e studimeve krahasimore ndërmjet popujve të ndryshëm lidhni me çështje të caktuara socialkulturore?

- A) Anketa sociologjike
- B) Eksperimenti sociologjik
- C) Fokus-grupet
- D) Studimi i historive të jetës

Pyetja 102.

Cila metodë përdoret përgjithësisht më rrallë në studimet sociologjike?

- A) Anketa sociologjike
- B) Eksperimenti sociologjik
- C) Fokus-grupet
- D) Intervista sociologjike

Pyetja 103.

Si karakterizohet në studimet sociologjike ndryshimi i modeleve të sjelljes së njerëzve, kur ata kuptojnë se po i studiojnë sociologët?

- A) Efekt bumerang
- B) Efekt dopler
- C) Efekt hauthorne
- D) Efekt matheu

Pyetja 104.

Cilat të dhëna të grumbulluara me metoda sociologjike janë më të përshtatshme për t'u përpunuar me programe kompjuterike?

- A) Të dhënat e grumbulluara nga eksperimenti sociologjik.
- B) Të dhënat e grumbulluara nga fokus-grupet
- C) Të dhënat e grumbulluara nga pyetjet e strukturuar të anketave
- D) Të dhënat e grumbulluara nga studimi i historive të jetës

Pyetja 105.

Cila metodë e kërkimeve sociologjike është më e përshtatshme për studimin e mendimeve origjinale të një njeriu të panjohur?

- A) Anketa
- B) Intervista e lirë
- C) Intervista e strukturuar
- D) Vëzhgim jopjesëmarrës

Pyetja 106.

Në vëzhgimin e tij pjesëmarrës në një spital psikiatrik, nga cili këndshikim i interpreton të dhënat e studimit sociologu i shquar i Erving Gofman?

- A) Nga këndshikimi i drejtuesve të spitalit
- B) Nga këndshikimi i mjekëve
- C) Nga këndshikimi i pacientëve
- D) Nga këndshikimi i personelit ndihmës të spitalit

Pyetja 107.

Cila qe përvoja më delikate, më e vështirë e studiuesit Frank Hamilton Cushing në vëzhgimet e tij pjesëmarrëse për veprimtarinë e banorëve, indianë të fisit Zuni të New Meksikos në vitet 1870?

- A) Kur drejtuesit e fisit i kërkuan të flinte në të njëjtët krevate si ato
- B) Kur drejtuesit e fisit i kërkuan të kryente të njëjtat rituale fetare si ato
- C) Kur drejtuesit e fisit i kërkuan të martohesh me një femër të fisit Zuni
- D) Kur drejtuesit e fisit i kërkuan të ushqehesh si ato

Pyetja 108.

Në rrethanat e shoqërisë shqiptare, cili burim ofron përgjithësisht më pak informacion për studimet sociologjike?

- A) Artikujt e botuar në gazeta
- B) Ditaret vetjake të botuar
- C) Dokumentet zyrtare të botuara
- D) Dokumentet zyrtare të pabotuara

Pyetja 109.

Me cilin besim fetar është i lidhur sistemi shoqëror i kastave më i përhapur në botë?

- A) Hinduizmi
- B) Islamizmi
- C) Judaizmi
- D) Krishterimi

Pyetja 110.

Cili faktor përcakton një valë më të fortë mobiliteti social me kahje për lart në shoqëritë më të industrializuara të pas Luftës së Dytë Botërore?

- A) Rritja e vëllimit të punës fizike në sektorin e industrisë
- B) Rritja e vëllimit të punës së gjallë në sektorin e bujqësisë
- C) Rritja e vëllimit të punës fizike në sektorin e ndërtimit
- D) Rritja e vëllimit të punës profesionale dhe administrative

Pyetja 111.

Çfarë janë tabutë?

- A) Norma kulturore ndaluese
- B) Norma kulturore urdhëruese
- C) Simbole kulturore
- D) Vlera kulturore

Pyetja 112.

Cilat përbërëse të kulturës shqiptare pasqyrohen më shumë në kanunet shqiptare?

- A) Kultura materiale
- B) Normat kulturore
- C) Simbolet kulturore
- D) Vlerat kulturore

Pyetja 113.

Si karakterizohet nga pikëpamja e sociologjisë së kulturës Lëvizja Demokratike e Studentëve të Dhjetorit 1990 në Shqipëri?

- A) Etnocentrizëm
- B) Ksenocentrizëm

- C) Kundërkulturë
- D) Subkulturë

Pyetja 114.

Cila grup-moshë është më e prirur të përfshihet në lëvizje kundërkulturore?

- A) Fëmijët
- B) Njerëzit në moshë të mesme
- C) Të moshuarit
- D) Të rinjtë

Pyetja 115.

Çfarë nxit rritja e shkallës së përhapjes së programeve televizive në shumicën e kulturave të botës?

- A) Kultivimin e vetëdijes së relativizmit kulturor
- B) Përforcimin e mendësive me natyrë etnocentrike
- C) Përforcimin e mendësive me natyrë ksenocentrike
- D) Shtimin e numrit të subkulturave

Pyetja 116.

Cila kategori e prindërve në shoqërinë shqiptare të ditëve tona është më e prirur t'i nxisë fëmijët të vazhdojnë traditën e tyre profesionale?

- A) Prindërit fermerë
- B) Prindërit intelektualë
- C) Prindërit punëtorë
- D) Prindërit zanatçinj

Pyetja 117.

Cili tip shoqërie krijon rrethanat për fëmijën të shpejtuar?

- A) Shoqëria e komunës primitive
- B) Shoqëria skllavopronare
- C) Shoqëria feudale
- D) Shoqëria moderne e ditëve tona

Pyetja 118.

Cila agjenci shoqërizimi ndikon më shumë për t'i vetëdijësuar natyrshëm njerëzit për ekzistencën e kulturave të shumëllojshme, që i zgjidhin në mënyra të ndryshme shumë probleme?

- A) Familja
- B) Grupet e bashkëmoshatarëve
- C) Opinioni publik

D) Televizioni

Pyetja 119.

Cili është më i rrezikuar të dyshohet për sjellje deviante ose krim në një shoqëri moderne të ditëve tona?

- A) Një artist i shquar
- B) Një biznesmen i pasur
- C) Një lypsar i varfër
- D) Një politikan i njohur

Pyetja 120.

Në cilin tip shoqërie kanë qenë më të përhapura krimet e “jakave të bardha”?

- A) Shoqëria e komunës primitive
- B) Shoqëria skllavopronare
- C) Shoqëria feudale
- D) Shoqëria moderne

Pyetja 121.

Në cilin tip krimi përfshihen më rrallë adoleshentët në shoqëritë moderne të ditëve tona?

- A) Krime kundër jetës së tjetrit
- B) Krime kundër pasurisë së tjetrit
- C) Krime “të jakave të bardha”
- D) Krime të mërisë ose të urrejtjes

Pyetja 122.

Ç’është gjenocidi?

- A) Asimilimi i grupeve etnike
- B) Izolimi i grupeve etnike
- C) Shfarosje e grupeve etnike
- D) Vetëveçimi i grupeve etnike

Pyetja 123.

Në cilat situata edhe njerëzit më pak besimtarë priren t’u luten forcave hyjnore?

- A) Në ceremoni gëzimesh
- B) Në kohën e lirë
- C) Në luftime të ashpra
- D) Në punën e përditshme

Pyetja 124.

Karakteristike e cilës fe botërore është i ashtuquajtimi konvinent?

- A) Budizmi
- B) Islamizmi
- C) Judaizmi
- D) Krishtërimi

Pyetja 125.

Në cilin tip shoqërie janë më të pranishme prirjet shekullarizuese?

- A) Shoqëria e komunës primitive
- B) Shoqëria skllavopronare
- C) Shoqëria feudale
- D) Shoqëria moderne

Pyetja 126.

Cila nga fetë e poshtëshënuara përhapet më me vështirësi në shoqëri të tjera, përveç asaj ku është formuar?

- A) Hundaizmi
- B) Islamizmi
- C) Judaizmi
- D) Krishtërimi

Pyetja 127.

Çfarë ka nxitur më shumë shteti totalitar socialist në Shqipëri në vitet 1944-1990?

- A) Fuqizimin e një feje në raport me një tjetër
- B) Konfliktimin e besimtarëve të feve të ndryshme
- C) Prirjet fundamentaliste
- D) Proceset shekullarizuese

Pyetja 128.

Cili qytet dëshmoi i pari përparësitë e mënyrës urbane të jetesës në krahasim me mënyrën rurale të jetesës?

- A) Xheriko
- B) Athina
- C) Roma
- D) Londra

Pyetja 129.

Cili proces urban ndikon më shumë në krijimin e megalopoliseve?

- A) Krijimi i fshatrave urbane
- B) Përtëritja urbane
- C) Shpërqendrimi urban

D) Xhentrifikimi

Pyetja 130.

Cili tip shoqërie u ka afruar më shumë mundësi për zgjedhje shumicës së anëtarëve të vet?

- A) Shoqëria e komunës primitive
- B) Shoqëria skllavopronare
- C) Shoqëria feudale
- D) Shoqëria moderne

Pyetja 131.

Cili tip revolucioni ka ndikuar më drejtpërdrejt në krijimin e shoqërisë pasmoderne?

- A) Revolucioni industrial
- B) Revolucioni i informacionit
- C) Revolucioni politik modern
- D) Revolucioni i tretë urban

Pyetja 132.

Cila fazë e procesit të shoqërizimit karakterizohet më e trazuar emocionalisht?

- A) Adoleshenca
- B) Moshë e rritur e hershme
- C) Moshë e pjekurisë
- D) Pleqëria

Pyetja 133.

Si quhen në studimet sociologjike grupimet e popullsisë që kanë të përbashkëta me gjithë shoqërinë simbole, vlera, norma dhe modele të tjera të kulturës sunduese, por që ndryshojnë kulturalisht në aspekte të veçanta?

- A) Folkuej
- B) Kundërkulturë
- C) More
- D) Nënkulturë

Pyetja 134.

Cili tip shoqërie ka pasur ritme zhvillimi më ngadalshme?

- A) Shoqëria e komunës primitive
- B) Shoqëria skllavopronare
- C) Shoqëria feudale
- D) Shoqëria moderne

Pyetja 135.

Cila nga fetë botërore është trajtuar më gjerësisht edhe si filozofi në auditorët e universiteteve?

- A) Budizmi
- B) Hinduizmi
- C) Judaizmi
- D) Konfucionizmi

Pyetja 136.

Cili Sociolog i ka kushtuar më shumë vëmendje analizës të anëve funksionale të deviancës ?

- A) Dyrkheim
- B) Konti
- C) Spenser
- D) Veber

Pyetja 137.

Cilit drejtim teorik i përkasin idetë e Lombrozës ?

- A) Teoria biologjike
- B) Teoria e anomisë
- C) Teoria e etiketimit
- D) Teoria psikologjike

Pyetja 138.

Sipas statistikave zyrtare në vendin tonë, cila formë e krimit kryhet më dëndur nga të rinjtë?

- A) Abuzimi me taksat
- B) Krimi ndaj pronës
- C) Marrja e rryshfeteve
- D) Përdorimi i pushtetit për përfitime

Pyetja 139.

Deri në cilin shekull në shumicën e vendeve europiane zbatoheshin ndëshkimet tradicionale dhe jo izolimi në burg ?

- A) Në shekullin 17
- B) Në shekullin 18
- C) Në shekullin 19
- D) Në shekullin 20

Pyetja 140.

Sipas studiuesit Sheldon , cili prej tipeve kryesore të fizikut lidhet drejtpërdrejt me krimin?

- A) Ectomorphs
- B) Endomorphs
- C) Individë që ndryshojnë nga përbërja kromozomike
- D) Mesomorphs

Pyetja 141.

Me çfarë i shpjegon rrënjët e krimit teoria e asosacionit diferencial ?

- A) Me trashëgiminë gjenetike
- B) Me elementët social
- C) Me faktorët biologjik
- D) Me veçoritë e personalitetit

Pyetja 142.

Cili nga sociologët ka përdorur për herë të parë konceptin “anomi” ?

- A) Cohen
- B) Dyrkheim
- C) Merton
- D) Ohlin

Pyetja 143.

Si i cilësonte Mertoni individët që pranojnë vlerat e pranuar nga shoqëria , por përdorin mjete të paligjëshme për plotësimin e tyre?

- A) Konformistë
- B) Novatorë
- C) Ritualistë
- D) Të tërhequr

Pyetja 144.

Anominë Dyrkheimi e lidhte me :

- A) Arritjen e suksesit material
- B) Dëshirën e njerëzve për t`u bërë të famshëm
- C) Karrierën profesionale
- D) Kthesat e mëdha në jetën shoqërore

Pyetja 145.

Cila nga teoritë e mëposhtëme e interpreton shmangien si një proces të ndërveprimit midis devijuesve dhe jodevijuesve?

- A) Teoria biologjike
- B) Teoria e anomisë
- C) Teoria e etiketimit
- D) Teoria psikologjike

Pyetja 146.

Cili nga studjuesit ka përdorur për herë të parë termin “krimi i zyrtarëve”?

- A) Dyrkheim
- B) Konti
- C) Merton
- D) Southerland

Pyetja 147.

Cili tip krimi sjell pasoja shumë të rënda në shoqëri?

- A) Krimet e vogla të të varfëve
- B) Përdorimi i drogës nga individit
- C) Ryshfetet që marrin nëpunësit
- D) Tërheqja e individit pas bixhozit

Pyetja 148.

Për cilën formë krimi krijohen agjenci të posaçme për t'i zbuluar ?

- A) Për krimin e “jakava të bardha”
- B) Për krimin ndaj personave
- C) Për krimin pa viktimë
- D) Për vjedhjet që bëjnë të varfërit

Pyetja 149.

Cili studiues shihte korelacion midis karrierës deviante dhe nofkës përçmuese?

- A) Dyrkheim
- B) Gofman
- C) Lemert
- D) Ohlin

Pyetja 150.

Cila është veçoria e studimeve për sjelljet deviante nga Rikles dhe Dinitz ?

- A) Analizuan karakteristikat biologjike të individëve për prirje të veçanta devijante
- B) Gjetën lidhje ndërmjet përbërjes kromozomike dhe prirjeve të sjelljeve devijante
- C) Studiuan veçoritë e grupimeve nënkulturore devijante
- D) Zbuluan lidhjen ndërmjet karakteristikave të personalitetit dhe kriminalitetit të të rinjve

Pyetja 151.

Cili sociolog i ka kushtuar më shumë vëmendje studimit të nënkulturave deviante ?

- A) Dyrkheim
- B) Lombroza
- C) Ohlin
- D) Southerland

Pyetja 152.

Në cilin shekull në shumicën e vendeve perendimore u hoq dënimi me vdekje ?

- A) Në shekullin 18
- B) Në shekullin 19
- C) Në shekullin 20
- D) Në shekullin 21

Pyetja 153.

Në cilën periudhë të zhvillimit të qytetit shumica e banorëve filluan të punësohen jashtë ekonomisë familjare ?

- A) Në qytetet e sotme në zhvillim .
- B) Në qytetet industriale
- C) Në qytetet paraindustriale
- D) Në qytetet pasindustriale

Pyetja 154.

Cilën dukuri të jetës urbane studio me përparësi Doksiadis ?

- A) Mobilitetin
- B) Pamjaftueshmërinë urbane
- C) Pjesmarrjen qytetare
- D) Stratifikimin urban

Pyetja 155.

Në cilin shekull Gotman përdori termin megalopolis?

- A) Shekulli 17
- B) Shekulli 18
- C) Shekulli 19
- D) Shekulli 20

Pyetja 156.

Cila shkollë teorike trajtoi me përparësi drejtimin ekologjik në analizën urbane ?

- A) Teoria e Çikagos
- B) Teoria e Castells-it
- C) Teoria e Dyrkheim-it
- D) Teoria e Harvey-it

Pyetja 157.

Cila teori shpjegon në mënyrë më të detajuar procesin e shpërqëndrimit të qyteteve në SHBA?

- A) Teoria e Dyrkhem-it
- B) Teoria e Harris-it
- C) Teoria e Simmelit-it
- D) Teoria e Wirth-it

Pyetja 158.

Cili nga studiuesit i përket drejtimit tipologjik të shpjegimit të jetës urbane?

- A) Castells
- B) Harvey
- C) Lefebvre
- D) Wirth

Pyetja 159.

Cila teori qytetin e sheh si shprehje të konsumit kolektiv?

- A) Teoria e Castells-it
- B) Teoria e Çikagos
- C) Teoria e Harvey-it
- D) Teoria e Wirth-it

Pyetja 160.

Cila nga teoritë e mëposhtme mbështetet tek darvinizmi social për të shpjeguar jetën e qytetit?

- A) Teoria e Çikagos
- B) Teoria e Dyrkheim-it
- C) Teoria e Harvey-it

D) Teoria e Lefebvresë

Pyetja 161.

Cila paradigmë teorike e lidh zhvillimin e hapsirës urbane me luftën e grupeve të papriviligjuara për të ndryshuar kushtet e jetesës?

- A) Teoria e Çikagos
- B) Teoria e Castells
- C) Teoria e Harvey-it
- D) Teoria e Wirth-it

Pyetja 162.

Profilizimi i qyteteve si rezultat i lidhjeve nderkombëtare është veçori :

- A) E qyteteve paraindustriale
- B) E qyteteve industriale
- C) E qyteteve pasindustriale
- D) E qyteteve të vendeve në zhvillim

Pyetja 163.

Cili element i mëposhtëm shënoi fillimin e revolucionit të dytë urban ?

- A) Ndërtimet e reja arkitektonike
- B) Përmirësimi i eko-sistemit urban
- C) Rritja e veprimtarisë tregtare
- D) Shpikja e makinës me avull

Pyetja 164.

Çfarë nënkupton sipas Braudelit koncepti “ekonomi e përmbysur” ?

- A) Ardhjen e fshatarëve në zonat urbane
- B) Vënien e demografisë në shërbim të ekonomisë
- C) Vënien e ekonomisë në shërbim të demografisë
- D) Përpjekjet e banorëve për t`u ngritur nga ana profesionale

Pyetja 165.

Cili model arkitektonik dhe shoqëror shpreh procesin e shpërqëndrimit të qyteteve në SHBA ?

- A) Modeli i qytetit të Paolo Solerit
- B) Modeli i rathëve koncentrikë
- C) Modeli i zhvillimit sektorial
- D) Modeli i shumë bërthamave

Pyetja 166.

Cili nga studjuesit ka analizuar me përparësi rolin e “solidaritetit organik” për zhvillimin e jetës urbane?

- A) Dyrkheim
- B) Merton
- C) Tocqueville
- D) Veber

Pyetja 167.

Cili nga sociologët e mëposhtëm ka analizuar komponentët e stratifikimit urban ?

- A) Konti
- B) Simel
- C) Spenser
- D) Veber

Pyetja 168.

Në cilën kulturë i ka rrënjët etimologjia e termit “kastë”:

- A) Kulturën angleze
- B) Kulturën indiane
- C) Kulturën portugeze
- D) Kulturën spanjolle

Pyetja 169.

Në cilin prej shteteve të mëposhtme termi “*kastë*” u përdor për të treguar konceptin e shumicës së teorive të shtresëzimit.

- A) Afrikë e Jugut
- B) Angli
- C) Indi
- D) SHBA

Pyetja 170.

Cili sociolog ka argumentuar se *‘ndarjet klasore burojnë jo vetëm nga kontrolli mbi mjetet e prodhimit, por edhe nga dallime ekonomike të tjera që nuk kanë të bëjnë me pronën drejtpërdrejt’*?:

- A) Erik Olin Wright
- B) Emile Durkheim
- C) Frank Parkin
- D) Max Weber

Pyetja 171.

Sipas Max Weber, cili ishte aspekti i dytë themelor përveç 'statusit':

- A) Partia
- B) Prestigji
- C) Privilegji
- D) Reputacioni

PS) A

Pyetja 172.

Cili nga sociologët e poshtëshënuar i ka karakterizuar kështu tri shtresat e klasës së lartë në shekullin e XIX : « *pronarët e mëdhenj të tokave, sipërmarrësit financiarë dhe industrialistët* »

- A) Frank Parkin
- B) John Scott
- C) Max Weber
- D) Paul Launt

B

Pyetja 173.

Sipas David Lockwood, ngase ndikohen më shumë përfytyrimet e njerzve për strukturën klasore:

- A) Rrethanat e mjedisit të tyre
- B) Niveli i pagave
- C) Vendi i punës
- D) Përvoja në profesion

Pyetja 174.

Me cilin nga konceptet e poshtëshënuara është lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë feminizimi i punës jofizike?:

- A) Dekualifikimin
- B) Kualifikimin
- C) Rikualifikimin
- D) Ripozicionimin

A

Pyetja 175.

Cili nga sociologët e poshtëshënuar mbrojti argumentin e "pozitës tradicionale" në analizën klasore sipas së cilës puna e paguar e gruas është e parëndësishme:

- A) Jean Elshtain
- B) John Goldthorpe
- C) Frank Parkin
- D) Michele Stanworth

Pyetja 176.

Në cilin nga shtetet e poshtëshënuara përqindja e njerëzve në punë fizike që arrijnë ato profesionale është më e lartë?

- A) Angli
- B) Francë
- C) Suedi
- D) SHBA

Pyetja 177.

Cili nga këta autorë ishte i pari që vendosi një standart të vazhdueshëm të varfërisë në dallimet mes *varfërisë absolute* dhe *varfërisë relative*?

- A) Charles Booth
- B) Clar Blackburn
- C) Peter Townsend
- D) William Booth

Pyetja 178.

Cila nga shoqëritë e poshtëshënuara njihet se ka kapërcyer pothuajse plotësisht nivelin e varfërisë absolute?

- A) Shoqëria amerikane
- B) Shoqëria angleze
- C) Shoqëria franceze
- D) Shoqëria suedeze

Pyetja 179.

Cila është metoda e dytë e vlerësimit të ‘varfërisë’ veç asaj të *varfërisë për ekzistencë*?

- A) Varfëria absolute
- B) Varfëria krahasuese
- C) Varfëria relative
- D) Varfëria e vazhdueshme

Pyetja 180.

Cfarë kuptimi fillestar ka termi “shkollë” me origjinë nga një fjalë e vjetër greke?

- A) Dije dhe mësim
- B) Kohë e lirë dhe çlodhje
- C) Punë
- D) Shkrim dhe lexim

Pyetja 181.

Cili nga shtetet e poshtëshënuara e ka më të decentralizuar sistemin e arsimit të lartë?

- A) Anglia
- B) Franca
- C) Italia
- D) ShBA

Pyetja 182.

Si e konsiderojnë arsimimin reformatorët në një sistem demokratik?

- A) Një qëllim në vetëvete
- B) Një pasojë të zhvillimit
- C) Një politikë gjithëpërfshirëse
- D) Një sistem vetë-përsëritës

Pyetja 183.

Cili nga studiuesit e poshtëshënuar njihet si hulumtuesi kryesor i *teorisë mbi aftësitë gjuhësore* gjatë procesit të shkollimit?

- A) Basil Bernstein
- B) Joan Tough
- C) Herbert Gintis
- D) Samuel Bowles

Pyetja 184.

Cila ishte pikpamja e Ivan Illich për *konsumin pasiv* në procesin e nxënies së dijes në shkollë?

- A) Ndjekja e detyrueshme e shkollës
- B) Pranim jokritik i rendit social ekzistues
- C) Shpërndarja e njerëzve në veprimtari profesionale sipas aftësive
- D) Zhvillimi i konceptit të disiplinës

Pyetja 185.

Për cilin nga konceptet e poshtëshënuara përdoret akronimi KI në kuadër të shkollimit?

- A) Kodi i inteligjencës
- B) Koeficienti i inteligjencës
- C) Koeficienti i interesit
- D) Kuiz intelekti

Pyetja 186.

Cili nga faktorët e mëposhtëm konsiderohet si avantazhi kryesor i pyetsorëve të standartizuar kundrejt atyre të pastandardizuar?

- A) Aftësia e intervistuesit për të mbledhur të dhënat
- B) Burimet financiare të përdorshme
- C) Koha e shkurtër e grumbullimit të të dhënave
- D) Kampioni i përdorur

Pyetja 187.

Çfarë karakteristike kryesore duhet të gëzojë kampioni i përzgjedhur për fokus studimi?

- A) Konfidencialiteti
- B) Përcaktimi
- C) Përfaqësimi
- D) Rastësia

Pyetja 188.

Cila nga etapat e poshtëshënuara qëndron ndërmjet *shfletimit të literaturës* dhe *zgjedhjes së një projekti kërkimor*?

- A) Aplikimi i anketës apo pyetsorit
- B) Formulimi i hipotezës
- C) Konstatimet e regjistruara nga ana e studiuesit
- D) Përcaktimi i problemit

Pyetja 189.

Cili nga sociologët e poshtëshënuar njihet si themelues i *Shentologjisë*?

- A) John Barnes
- B) Lafayette Ronald Hubbard
- C) Roy Wallis
- D) Stanley Milgram

Pyetja 190.

Si cilësohen nga Giddens sipërfaqet mbi të cilat autoritetet politike të qëndrueshme shtrijnë sundimin e tyre?

- A) Hapësire publike
- B) Hapësire e ligjit
- C) Popullate
- D) Territor

Pyetja 191.

Cila nga karakteristikat e mëposhtme sipas Giddens i përket nocionit të shtetit ?

- A) Elita
- B) Përdorimi i forcës
- C) Sistemet partiake
- D) Theçerizmi

Pyetja 192.

Cili nga nocionet e mëposhtme përkufizohet nga Giddens si “Zotërimi nga ana e një qeverie e pushtetit mbi një sipërfaqe me kufij të përcaktuar brenda të cilave ajo është fuqia supreme?”

- A) Hegjemoni
- B) Legjitimitet
- C) Sovranitet
- D) Shtet-formim

Pyetja 193.

Cila nga format e mëposhtme të pjesëmarrjes korrespondon me konceptin e të drejtave politike?

- A) Aderimi në sindikata
- B) Anëtarësimi në shoqata
- C) Pjesëmarrja në zgjedhje
- D) Vendimmarrja në familje

Pyetja 194.

Si cilësohen nga Giddens organizatat, të cilat orientohen drejt arritjes së kontrollit të ligjshëm të qeverisjes përmes procesit elektoral?

- A) Grupe interesi
- B) Parti politike
- C) Sindikata
- D) Shoqëri civile

Pyetja 195.

Ku bazohet sistemi elektoral “mazoritar”?:

- A) Te kandidati
- B) Te koalicioni
- C) Te partia
- D) Te shoqata politike

Pyetja 196.

Si cilësohen nga Giddens partitë “e djathta”?

- A) Etnike
- B) Komuniste

- C) Konservatore
- D) Socialiste

Pyetja 197.

Cili nga tiparet e mëposhtme është element perberes i definicionit të “theçerizmit”:

- A) Kufizimi i rolit të shtetit
- B) Mosbesimi tek forcat e tregut
- C) Reduktimi i lirive individuale
- D) Rritja e taksave

Pyetja 198.

Teoria e “krizës së kredibilitetit” të shtetit u zhvillua nga:

- A) Friedman
- B) Etizioni-Halevy
- C) Habermas
- D) Thatcher

Pyetja 199.

Giddens cilëson si “demokraci përfaqësuese” ato demokraci ku:

- A) Vendimet merren jo nga anëtarët e komunitetit por nga personat e zgjedhur
- B) Vendimet merren jo nga personat e zgjedhur por nga anëtarët e komunitetit
- C) Vendimet merren nga shumica e anëtarëve të komunitetit
- D) Vendimet merren vetëm nga personat e zgjedhur

Pyetja 200.

Cili nga konceptet e mëposhtme ilustron më mirë formën e “demokracisë pjesëmarrëse”:

- A) Organizata
- B) Protesta
- C) Peticioni
- D) Referendumi

Pyetja 201.

Cilin nga kushtet e mëposhtëm i përmban pikëpamja e Veberit për “elitizmin demokratik”?

- A) Parti që përfaqësojnë interesat dhe këndvështrime të ndryshme
- B) Pushtet i gjere i burokrateve mbi udhëheqësit politikë
- C) Qytetarë që mbledhen rregullisht për të marrë vendime
- D) Udhëheqje me njohuri profesionale dhe burokratike

Pyetja 202.

Çfarë është “demokracia” sipas Schumpeter?

- A) Sundimi i ekonomisë dhe jo i popullit
- B) Sundimi i politikanit dhe jo i popullit
- C) Sundimi i popullit dhe jo i politikanit
- D) Sundim i popullit dhe jo i ekonomisë

Pyetja 203.

Sipas Giddens, ç’natyrë të interesave të grupeve në sistemit politik të shoqërive moderne, thekson teoria pluraliste?

- A) Bashkëpunuese
- B) Ekskluzive
- C) Konkurruese
- D) Kontradiktore

Pyetja 204.

Politiken e cilit shtet përfaqësojnë teoritë pluraliste?

- A) Britanisë së Madhe
- B) Francës
- C) Gjermanisë
- D) SHBA

Pyetja 205.

Cili nga pohimet e mëposhtme konsiderohet nga Giddens si kritike ndaj teorisë së “elitizmit demokratik”?

- A) Barazia e pushtetit
- B) Konkurrenca mes grupeve
- C) Papërgjegjshmëria burokratike
- D) Pasiviteti i elektoratit

Pyetja 206.

Cili nga pohimet e mëposhtme i përgjigjet me sakte shpjegimit të nivelit social ose kulturor të komunikimit?

- A) Niveli i krijueshmërisë në demokracitë tona
- B) Niveli i mekanizmave themelore të pranuar si hipoteza nga shkencat
- C) Niveli i shprehjes së identiteteve dhe diferencave
- D) Niveli nga i njëjti tek i njëjti

Pyetja 207.

Si njihet fundi i shekullit të XIX në zhvillimin e shkencës sociale të komunikimit?

- A) Dështimi i shkencës sociale të komunikimit
- B) Kthimi i reflektimit mbi objektet

- C) Te menduarit e komunikimit si hapësirë publike
- D) Zhvillimi i një shkence të vërtetë sociale të komunikimit

Pyetja 208.

Cilit autor i përket koncepti i komunikimit si “hapësirë publike”?

- A) Barthes dhe Eco
- B) De Saussure
- C) Habermas
- D) Lazarsfeld

Pyetja 209.

Cili autor përdori termin “shiringe hipodermike” për të treguar ndikimin që pëson audiencia pasive ndaj komunikimit masiv?

- A) Halold D. Laswell
- B) Ivan P. Pavlov
- C) John B. Watson
- D) Kurt Levin

Pyetja 210.

Cila nga ngjarjet e mëposhtme shpreh sipas E. Maigret friken prej efekteve të mediave?

- A) Ndikimi i muzikës rok për rritjen e divorceve
- B) Ndikimi i romaneve për rritjen e kriminalitetit
- C) Ndikimi i radios për ardhjen në pushtet të Hitlerit
- D) Ndikimi i televizionit për rritjen e analfabetizimit

Pyetja 211.

Cili nga tiparet e mëposhtme karakterizon modernitetin, sipas studiuesve të Shkollës së Frankfurtit?

- A) Demokratizimi i marrëdhënieve njerëzore
- B) Kolektivizimi i marrëdhënieve njerëzore
- C) Komercializimi i marrëdhënieve njerëzore
- D) Kulturalizimi i marrëdhënieve njerëzore

Pyetja 212.

Si u vetëquaj studimi i mediave dhe i publikut të tyre duke nisur nga vitet '40 të shekullit XX nën udhëheqjen e Paul Lazarsfeld?

- A) Rryme empirike
- B) Rryme kibernetike
- C) Rryme kritike
- D) Rryme logjike

Pyetja 213.

Çfarë tregoi studimi i Lazarsfeld “the People’s Choice” (1944) ne lidhje me votën?

- A) Vota nuk është vetëm zgjedhje individuale
- B) Vota nuk varet nga klasa
- C) Vota nuk varet nga gjinia
- D) Vota nuk varet nga feja

Pyetja 214.

Si quhet ekspozimi ndaj medias i cili është ne funksion te interesit social dhe personal qe u dedikohet atyre?

- A) I tërthortë
- B) Normativ
- C) Përforcues
- D) Selektiv

Pyetja 215.

Cili nga tiparet e mëposhtme i atribuohet “liderëve te opinionit publik”?

- A) Efekti i propagandës
- B) Ekspozimi selektiv
- C) Kontrolli i informacionit
- D) Marrëdhënia me stimulin

Pyetja 216.

Si njihet teoria e Lazarsfeld mbi komunikimin?

- A) Teoria e efekteve horizontale
- B) Teoria e efekteve te drejtpërdrejta
- C) Teoria e efekteve te kufizuara
- D) Teoria e efekteve vertikale

Pyetja 217.

Cili nga pohimet e mëposhtme i përket studiuesit te komunikimit Marschall McLuhan?

- A) Koordinimi është problem komunikimi
- B) Mediat nuk krijojnë dhune ex nihilo
- C) Mediumi është mesazhi
- D) Politika e vërtetë nuk behet ne televizion

Pyetja 218.

Mbi cilin proces e bazon Veber teorinë e industrive kulturore?

- A) Te demokratizimi

- B) Te industrializimi
- C) Te shekullarizimi
- D) Te urbanizimi

Pyetja 219.

Cila nga rrymat e mëposhtme te mendimit karakterizon me mire shkollën amerikane te komunikimit?

- A) Idealizmi
- B) Pozitivizmi
- C) Pragmatizmi
- D) Racionalizmi

Pyetja 220.

Çfarë është “i shënjuari” sipas teorisë gjuhësore te De Saussure?

- A) Bartësi
- B) Kuptimi
- C) Mendimi
- D) Shenja

Pyetja 221.

Ne cilin nga konceptet e Durkheim i ka rrënjët teoria gjuhësore e De Saussure?

- A) Anomia
- B) Fakti social
- C) Kohezioni
- D) Solidariteti

Pyetja 222.

Si quhet disiplina e cila studion marrëdhëniet mes shenjave dhe sendeve?

- A) Behaviorism
- B) Semantike
- C) Semiologji
- D) Semiotike

Pyetja 223.

Cilës dukuri shoqërore i referohet Abrams me cilësimin “veprim masiv me objektiv arritjen e një rindërtimi thelbësor te shoqërisë”?

- A) Grushtit shtetit
- B) Lëvizjes politike
- C) Revolucionit
- D) Terrorizmit

Pyetja 224.

Cila nga karakteristikat e mëposhtme duhet te pasoje një numër ngjarjesh qe lëvizjet sociale te ndodhura te quhen “revolucion”?

- A) Dhuna
- B) Reformat
- C) Revoltat
- D) Zgjedhjet

Pyetja 225.

Sipas Giddens, cili grupim shoqëror luajti rolin kryesor ne Revolucioni rus te 1917?

- A) Fshatarësia
- B) Klasa punëtore
- C) Klasa e mesme
- D) Monarkia

Pyetja 226.

Cili është kushti i domosdoshëm për zhvillimin e revolucionit sipas teorisë se Chalmers Johnson për revolucionet?

- A) Analogjia mes shoqërive
- B) Çekuilibri i shoqërive
- C) Ekuilibri i shoqërive
- D) Rritja e shoqërive

Pyetja 227.

Cila nga dukuritë e mëposhtme sociale përben shkak për ndodhjen e revolucioneve sipas teorisë se James Davis:

- A) Cenimi i harmonisë
- B) Privimi relativ
- C) Shtypja e ashpër
- D) Varfëria e plote

Pyetja 228.

Si përkufizohet nga Giddens, “veprimi i disa njerëzve se bashku për realizimin e qëllimeve te përbashkëta”?

- A) Veprim kolektiv
- B) Veprim social
- C) Veprim refleksiv
- D) Veprim revolucionar

Pyetja 229.

Cili mendimtar i konsideron lëvizjet revolucionare si veprim kolektiv që ndodh në situata të "sovrانيتit të shumëfishtë"?

- A) Antony Giddens
- B) Chalmers Johnson
- C) Charles Tilly
- D) Theda Skocpol

Pyetja 230.

Cila dukuri shoqërore përkufizohet nga Giddens si "ushtim sistematik i dhunës për të detyruar nënshkrimin ndaj autoriteteve të reja"?

- A) Grusht shteti
- B) Kryengritje e armatosur
- C) Pas-revolucion
- D) Terror revolucionar

Pyetja 231.

Cili nga objektivat e mëposhtme shpreh sipas Giddens qëllimin e lëvizjeve sociale reformuese?

- A) Ndryshime rrënjësore, të gjithanshme dhe shpesh me dhunë
- B) Ndryshimin e disa aspekteve të rendit shoqëror ekzistues
- C) Ndryshimin e zakoneve dhe botëkuptimit të individëve
- D) Shpëtimin nga mënyra jetese të konsideruara si korruptuese

Pyetja 232.

Si cilësohet nga Giddens, pikëpamja e Alain Touraine që thotë se "shoqëritë moderne dallohen nga njohja e proceseve shoqërore e cila përdoret për të riformuar kushtet e ekzistencës sonë"?

- A) Anonimitet
- B) Historicitet
- C) Refleksivitet
- D) Funkcionalizem

Pyetja 233.

Cilat nga elementet e mëposhtëm është element i veprimit kolektiv sipas Tilly:

- A) Demotivimi
- B) Interesat e përveçme
- C) Mungesa e sovranitetit
- D) Rasti i volitshëm

Pyetja 234.

Cilit autor te shoqërizimit te foshnjave i përket teza se “dashuria e nënës ne fëmijëri është po aq e rëndësishme për shëndetin mendor sa edhe vitaminat dhe proteinat për shëndetin fizik”?

- A) Bowlby
- B) Freud
- C) Harlow
- D) Mead

Pyetja 235.

Cili nga konceptet e mëposhtme lidhet me kontributin e psikanalizës se Freudit për studimin e fëmijërisë?

- A) E pavetëdijshmja
- B) Mendja
- C) Shoqëria
- D) Vetja

Pyetja 236.

Sipas Giddens, bazën e cilës perspektive sociologjike hodhi G. H. Mead ne veprën e tij “Mendja, Vetja dhe Shoqëria” (1934)?

- A) Funkcionalizmit
- B) Materializmit historik
- C) Ndërveprimet simbolik
- D) Strukturalizmit

Pyetja 237.

Si e quan G.H. Mead vetëdijen për ta parë veten siç e shohin te tjerët?

- A) Vetja dinamike
- B) Vetja e përgjithësuar
- C) Vetja e plotësuar
- D) Vetja sociale

Pyetja 238.

Si i quan G. H. Mead, vlerat e përgjithshme dhe rregullat morale te përfshira ne kulturën ku individi zhvillohet?

- A) Marrje e rolit te tjetrit
- B) Shoqëri
- C) Tjetri i përgjithësuar
- D) Vetja sociale

Pyetja 239.

Si quhet nga G. H. Mead fazën kur fëmijët fitojnë një kuptim të zhvilluar për veten, duke e pare atë si një veprues të veçuar?

- A) Mua
- B) Një
- C) Tjetër
- D) Unë

Pyetja 240.

Si quhet nga Piaget faza e zhvillimit të fëmijëve të moshës 11 deri 15 vjeç, në të cilën fëmija aftësohet për të kuptuar ide abstrakte dhe hipotetike?

- A) Sensoriomotore
- B) Prapavepruese
- C) Vepruese formale
- D) Vepruese konkrete

Pyetja 241.

Ku bazohen marrëdhëniet që zhvillohen në “grupin e bashkëmoshatarëve”?

- A) Gjininë
- B) Pëlqimin e ndërsjellë
- C) Varësinë
- D) Vendndodhjen

Pyetja 242.

Cilit faktor shoqërizues i referohen sociologët kur flasin për “program të padukshëm”?

- A) Familjes
- B) Shkollës
- C) Masm medias
- D) Grupit të bashkëmoshatarëve

Pyetja 243.

Sipas Giddens, në cilat rrethana ndodh procesi i rishoqërizimit?

- A) Institucion arsimor
- B) Institucion fetar
- C) Institucion izolimi
- D) Institucion prodhues

Pyetja 244.

Cili nga përkufizimet e mëposhtëm i përket etnisë?

- A) Një grup njerëzish që kanë të përbashkët besimin fetar
- B) Një grup njerëzish që kanë të përbashkët prejardhjen dhe gjuhën

- C) Një grup njerëzish që jetojnë në të njëjtin shtet
- D) Një grup njerëzish që simpatizojnë të njëjtin ekip futboll

Pyetja 245.

Cila nga thëniet e mëposhtme është e vërtetë për racizmin?

- A) Racizmi pajtohet me vlerat e një shoqërie demokratike dhe pluraliste
- B) Racizmi buron nga paragjykimet për epërsinë e një race mbi të tjerat
- C) Racizmi është ideologjia që mbështet barazinë e racave
- D) Racizmi nuk ndeshet në shoqëritë moderne perëndimore

Pyetja 246.

Si quhet sipas Robert K. Merton dikush që e konsideron veten pa paragjykime, por që shkon pas “rrymës” në rast se shumica i diskriminon pakicat?

- A) Fanatik aktiv
- B) Fanatik pasiv
- C) Plotësisht liberal
- D) Relativisht liberal

Pyetja 247.

Si quhet sipas Robert K. Merton dikush që nuk ka paragjykime dhe shmang gjithmonë diskriminimin ndaj pakicave?

- A) Fanatik aktiv
- B) Fanatik pasiv
- C) Plotësisht liberal
- D) Relativisht liberal

Pyetja 248.

Si quhet sipas Robert K. Merton dikush që ka paragjykime ndaj pakicave, por që mban një qëndrim asnjës?

- A) Fanatik aktiv
- B) Fanatik pasiv
- C) Plotësisht liberal
- D) Relativisht liberal

Pyetja 249.

Si quhet sipas Robert K. Merton dikush që ka paragjykime dhe i diskriminon pakicat?

- A) Fanatik aktiv
- B) Fanatik pasiv
- C) Plotësisht liberal
- D) Relativisht liberal

Pyetja 250.

Nëse emigrantët heqin dorë nga kultura e tyre e origjinës dhe përshtaten me kulturën e shumicës, cili model i marrëdhënieve etnike realizohet në këtë mënyrë?

- A) Asimilimi
- B) Diskriminimi
- C) Pluralizmi kulturor
- D) Shkrirja

Pyetja 251.

Nëse në një shoqëri njihet vlera e barabartë e kulturave të ndryshme, cili model i marrëdhënieve etnike realizohet në këtë mënyrë?

- A) Asimilimi
- B) Diskriminimi
- C) Pluralizmi kulturor
- D) Shkrirja

Pyetja 252.

Cilat nga fetë e poshtëshënuara është politeiste?

- A) Hinduizmi
- B) Islamizmi
- C) Judaizmi
- D) Krishtërimi

Pyetja 253.

Cila nga fetë e poshtëshënuara është më e re?

- A) Budizmi
- B) Islamizmi
- C) Judaizmi
- D) Krishtërimi

Pyetja 254.

Cili nga sociologët ka argumentuar më gjerësisht se feja është dallimi midis së shenjtës dhe profanes?

- A) Durkheim
- B) Spencer
- C) Simmel
- D) Weber

Pyetja 255.

Cili nga sociologët ka arsyetuar më gjerësisht se feja e largon vëmendjen e njeriut prej padrejtësive dhe pabarazive të kësaj bote?

- A) Durkheim
- B) Comte
- C) Simmel
- D) Weber

Pyetja 256.

7. Cili nga sociologët ka argumentuar më gjerësisht se feja mund të jetë një forcë revolucionare që shkakton ndryshime rrënjësore sociale?

- A) Durkheim
- B) Marks
- C) Simmel
- D) Weber

Pyetja 257.

Cila nga organizatat fetare është e përbërë nga një numër i vogël anëtarësh që mblidhen rreth një udhëheqësi karizmatik dhe hedhin poshtë vlerat e shoqërisë së jashtme?

- A) Dinominejshën
- B) Kisha
- C) Kulti
- D) Sekti

Pyetja 258.

Në cili sektor të ekonomisë industriale bën pjesë peshkimi?

- A) Sektori parësor
- B) Sektori dytësor
- C) Sektori tretësor
- D) Sektori katërsor

Pyetja 259.

Në cilin sektor të ekonomisë industriale bën pjesë prodhimi i qarqeve elektronike?

- A) Sektori parësor
- B) Sektori dytësor
- C) Sektori tretësor
- D) Sektori katërsor

Pyetja 260.

Në cili sektor të ekonomisë industriale bën pjesë mësimdhënia?

- A) Sektori parësor

- B) Sektori dytësor
- C) Sektori tretësor
- D) Sektori katërsor

Pyetja 261.

Si quhet sistemi i prodhimi masiv industrial, i shoqëruar me tregje masive?

- A) Fordizmi
- B) Korporatizmi
- C) Feudalizmi
- D) Sindikalizmi

Pyetja 262.

Cila është karakteristikë e sistemit pasfordist të prodhimit:

- A) Prodhimi fleksibël i mallrave dedikuar klientëve të caktuar
- B) Prodhimi i mallrave për konsumin vetjak të prodhuesit
- C) Prodhimi i mallrave për shkëmbime në natyrë
- D) Prodhimi i standardizuar me linjë montimi për tregje masive

Pyetja 263.

Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë?

- A) Etapa e kapitalizmit familjar pason atë të kapitalizmit institucional
- B) Etapa e kapitalizmit familjar pason atë të kapitalizmit menaxherial
- C) Etapa e kapitalizmit institucional pason atë të kapitalizmit menaxherial
- D) Etapa e kapitalizmit menaxherial pason atë të kapitalizmit institucional

Pyetja 264.

Si e përkufizon Anthony Giddens grevën?

- A) Ndalimi i përhershëm i punës nga një grup punëtorësh për të protestuar ndaj pronarit
- B) Ndalimi i përkohshëm i punës nga një grup punëtorësh për të protestuar ndaj pronarit
- C) Ndalimi i përkohshëm i punës nga një punëtor për të protestuar ndaj pronarit
- D) Ngadalësimi i ritmit të punës nga një grup punëtorësh për të protestuar ndaj pronarit

Pyetja 265.

Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë për individin e papunësuar?

- A) Administrimi i kohës është më i efektshëm
- B) Kontaktet sociale shtohen
- C) Niveli i ushtrimit të aftësive është i lartë
- D) Niveli i vetëvlerësimit është i ulët

Pyetja 266.

Cili nga pohimet e mëposhtëm është i vërtetë?

- A) Puna shtëpiake e grave është një pjesë e papërfillshme e ekonomisë kombëtare
- B) Puna shtëpiake e grave është rrjedhojë e ndarjes gjinore të punës
- C) Puna shtëpiake e grave nuk ndikon te puna prodhuese e burrave jashtë shtëpisë
- D) Puna shtëpiake grave vlerësohet më shumë se puna prodhuese e burrave

Pyetja 267.

Cili është parashikimi i Andre Gorz për të ardhmen e punës?

- A) Nivelet e papunësisë dhe të punësimit me orar të reduktuar do të ulen
- B) Numri i njerëzve që nuk do të përfshihen në punë të paguar do të rritet
- C) Puna e paguar do të luajë një rol më të rëndësishëm në jetët e njerëzve
- D) Punëtorët do të marrin në duart e tyre drejtimin e ndërmarrjeve ku punojnë

Pyetja 268.

Sipas Auguste Comte, cila është etapa më e lartë e përparimit njerëzor?

- A) Etapa kritike
- B) Etapa metafizike
- C) Etapa shkencore
- D) Etapa teologjike

Pyetja 269.

Sipas Auguste Comte, cila nga shkencat ndodhet më lart në hierarkinë e shkencave:

- A) Astronomia
- B) Biologjia
- C) Fizika
- D) Sociologjia

Pyetja 270.

3. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i vërtetë sipas teorisë së Auguste Comte?

- A) Rendi dhe progresi shoqëror bazohet mbi harmoninë midis grupeve shoqërore
- B) Rendi dhe progresi shoqëror bazohet mbi harmoninë midis interesave të individëve
- C) Rendi dhe progresi shoqëror bazohet mbi konfliktin midis grupeve shoqërore
- D) Rendi dhe progresi shoqëror bazohet mbi konkurrencën midis individëve

PS A

Pyetja 271.

Cili është sipas Herbert Spencerit tipari kryesor i shoqërive industriale:

- A) Shoqëritë industriale bazohen te bashkëpunimi i detyruar i individëve

- B) Shoqëritë industriale bazohen te bashkëpunimi i vullnetshëm i individëve
- C) Shoqëritë industriale bazohen te centralizimi i funksioneve
- D) Shoqëritë industriale bazohen te përjashtimi i organizatave private

Pyetja 272.

Cili nga pohimet e mëposhtëm është në pajtim me teorinë sociologjike të Herbert Spencerit?

- A) Shoqëria harmonike krijohet nga disiplina ushtarake dhe kufizimi i lirisë së individëve
- B) Shoqëria harmonike krijohet nga kontratat midis individëve që ndjekin interesat e veta
- C) Shoqëria harmonike krijohet nga ndërhyrja e shtetit në çështjet shoqërore
- D) Shoqëria harmonike krijohet nga përjashtimi i organizatave private të individëve

Pyetja 273.

Cili nga pohimet e poshtëshënuar është i vërtetë për konceptin e faktit social sipas Emile Durkheim?

- A) Faktet sociale janë jashtë individëve dhe janë detyrues ndaj tyre
- B) Faktet sociale mund të zgjidhen lirisht nga individi
- C) Faktet sociale ndodhen në imagjinatën e individit
- D) Faktet sociale nuk mund të studiohen nga sociologjia

Pyetja 274.

Cila nga më poshtë është një fakt social jomaterial sipas Emile Durkheim?

- A) Arkitektura baroke
- B) Kodi penal
- C) Legjendat popullore
- D) Teknologjia elektronike

Pyetja 275.

Cila nga më poshtë është një fakt social material sipas Emile Durkheim?

- A) Kodi penal
- B) Legjendat popullore
- C) Morali
- D) Përfaqësimet kolektive

Pyetja 276.

Sipas Emile Durkheim, cili nga argumentet e mëposhtëm është i vërtetë?

- A) Solidariteti organik është karakteristikë e shoqërive moderne
- B) Solidariteti organik është karakteristikë e ndarjes së ulët të punës

- C) Solidariteti organik është karakteristikë e shoqërive primitive
- D) Solidariteti organik i jep përparësi kolektivit ndaj individit

Pyetja 277.

Sipas Emile Durkheimit, cili nga argumentet e mëposhtëm është i vërtetë?

- A) Solidariteti mekanik buron nga ndarja e lartë e punës
- B) Solidariteti mekanik është karakteristikë e shoqërive moderne
- C) Solidariteti mekanik është karakteristikë e shoqërive primitive
- D) Solidariteti organik i jep përparësi individit ndaj kolektivit

Pyetja 278.

Cila nga shprehjet e mëposhtme për fenë i përket sociologjisë së Emile Durkheimit?

- A) Etapa shkencore e njerëzimit është më e lartë se sa ajo fetare
- B) Feja është opium për popullin
- C) Feja është shpallje e zotit për njerëzimin
- D) Njëpërmjet fesë, shoqëria bëhet e ndërgjegjshme për veten

Pyetja 279.

Cili nga pohimet e mëposhtëm është i vërtetë për konceptimin e Emile Durkheimit të organizatave profesionale?

- A) Organizatat profesionale harmonizojnë interesat e ndryshme në një sistem moral
- B) Organizatat profesionale mbrojnë interesat e pronarëve kundër punëtorëve
- C) Organizatat profesionale mbrojnë interesat e punëtorëve kundër pronarëve
- D) Organizatat profesionale me konkurrencën e tyre e bjerrin moralin e shoqërisë

Pyetja 280.

Cili nga pohimet e mëposhtëm është i vërtetë për “tipat idealë” sipas Max Weber?

- A) Tipat idealë bazohen te mesatarja statistikore
- B) Tipat idealë janë produkt i irracionalitetit
- C) Tipat idealë janë konstrukte logjike
- D) Tipat idealë janë përbërës të utopisë

Pyetja 281.

Cili është përkufizimi i Max Weberit për klasën sociale?

- A) Një komunitet i formuar nga vlerësimi shoqëror pozitiv apo negativ i nderit
- B) Një grup shoqëror që konkurren me grupe të tjerë për pushtet dhe dominim
- C) Një numër njerëzish që kanë të përbashkët shanset e jetës në kushtet e tregut
- D) Një numër njerëzish që nuk i zotërojnë mjetet e prodhimit

Pyetja 282.

Cili është përkufizimi i Max Weberit për grupin statutor?

- A) Një komunitet i formuar nga vlerësimi shoqëror pozitiv apo negativ i nderit
- B) Një grup shoqëror që konkurren me grupe të tjerë për pushtet dhe dominim
- C) Një numër njerëzish që kanë të përbashkët shanset e jetës në kushtet e tregut
- D) Një numër njerëzish që nuk i zotërojnë mjetet e prodhimit

Pyetja 283.

Cili është përkufizimi i Max Weberit për partinë?

- A) Një komunitet i formuar nga vlerësimi shoqëror pozitiv apo negativ i nderit
- B) Një grup shoqëror që konkurren me grupe të tjerë për pushtet dhe dominim
- C) Një numër njerëzish që kanë të përbashkët shanset e jetës në kushtet e tregut
- D) Një numër njerëzish që nuk i zotërojnë mjetet e prodhimit

Pyetja 284.

Ku bazohet sipas Max Weberit legjitimiteti tradicional i autoritetit?

- A) Mbi aftësitë e jashtëzakonshme të personit
- B) Mbi ligjshmërinë e institucionit
- C) Mbi pasurinë e personit
- D) Mbi shenjtërinë dhe lashtësinë e institucionit

Pyetja 285.

Ku bazohet sipas Max Weberit legjitimiteti racional i autoritetit?

- A) Mbi aftësitë e jashtëzakonshme të personit
- B) Mbi ligjshmërinë e institucionit
- C) Mbi pasurinë e personit
- D) Mbi shenjtërinë dhe lashtësinë e institucionit

Pyetja 286.

Ku bazohet sipas Max Weberit legjitimiteti karizmatik i autoritetit?

- A) Mbi aftësitë e jashtëzakonshme të personit
- B) Mbi ligjshmërinë e institucionit
- C) Mbi pasurinë e personit
- D) Mbi shenjtërinë dhe lashtësinë e institucionit

Pyetja 287.

Max Weberi procesin e shndërrimit të legjitimitetit karizmatik në legjitimitet tradicional ose racional, e quan

- A) Revolucionarizim i karizmës
- B) Ripërtëritje e karizmës

- C) Rutinizim i karizmës
- D) Vdekje e karizmës

Pyetja 288.

Sipas teorisë së Talcott Parsonsit, cili nga nënsistemet e shoqërisë kryen funksionin e adaptimit me situatën e jashtme?

- A) Ekonomia
- B) Komuniteti shoqëror
- C) Sistemi i mirëbesimit
- D) Shteti

Pyetja 289.

Sipas teorisë së Talcott Parsonsit, cili nga nënsistemet e shoqërisë kryen funksionin e arritjes së qëllimit?

- A) Ekonomia
- B) Komuniteti shoqëror
- C) Sistemi i mirëbesimit
- D) Shteti

Pyetja 290.

Sipas teorisë së Talcott Parsonsit, cili nga nënsistemet e shoqërisë kryen funksionin e integritetit të pjesëve përbërëse?

- A) Ekonomia
- B) Komuniteti shoqëror
- C) Sistemi i mirëbesimit
- D) Shteti

Pyetja 291.

Sipas teorisë së Talcott Parsonsit, cili nga nënsistemet e shoqërisë kryen funksionin e ruajtjes së rregullit?

- A) Ekonomia
- B) Komuniteti shoqëror
- C) Sistemi i mirëbesimit
- D) Shteti

Pyetja 292.

Sipas Shkollës Kritike, cili nga pohimet e mëposhtëm është i vërtetë

- A) Në botën moderne mbizotëron arsyeja thelbësore
- B) Në botën moderne mbizotëron liria për vetërealizimin e njeriut
- C) Në botën moderne mbizotëron mendimi teknokratik
- D) Në botën moderne mbizotëron solidariteti midis njerëzve

Pyetja 293.

Cili nga pohimet e mëposhtëm është i vërtetë për teorinë e Jurgen Habermasit?

- A) Racionaliteti i veprimit komunikativ nuk ka efekt mbi racionalitetin qëllimor
- B) Strukturat e dominimit shoqëror e deformatojnë komunikimin njerëzor
- C) Synimi i veprimit strategjik është arritja e kuptueshmërinë midis njerëzve
- D) Veprimi instrumental është më i rëndësishëm për shoqërinë se veprimi komunikativ

Pyetja 294.

Cili nga sociologët ka përdorur termat sistem-botë dhe gjysmë-periferi për të shpjeguar lindjen dhe përhapjen e kapitalizmit nëpër botë?

- A) Anthony Giddens
- B) Immanuel Wallerstein
- C) Jurgen Habermas
- D) Ulrich Beck

Pyetja 295.

Cila nga më poshtë është një kritikë e Teorisë Kritike (Shkolla e Frankfurtit) ndaj sociologjisë?

- A) Sociologjia nuk e pranon gjendjen e tanishme edhe synon ndryshimin shoqëror
- B) Sociologjia nuk e pranon hierarkinë klasore të shoqërisë borgjeze
- C) Sociologjia nuk i kushton sa duhet vëmendje ndërveprimit të individit me shoqërinë
- D) Sociologjia nuk ka zhvilluar metoda rigorozë shkencore për analizën e shoqërisë

Pyetja 296.

Sipas George Ritzer, cila nga të mëposhtmet është një karakteristikë e pasfordizmit?

- A) Homogjenizimi i konsumit
- B) Përdorimi i teknologjive të pandryshueshme
- C) Prodhim i produkteve më të specializuara
- D) Rutina të standardizuara të punës

Pyetja 297.

Cili nga sociologët ka përdorur për herë të parë termin “mekdonaldizimi i shoqërisë” për të shpjeguar dinamikën e modernitetit të sotëm?

- A) Anthony Giddens
- B) George Ritzer
- C) Ulrich Beck
- D) Zygmunt Bauman

Pyetja 298.

2. Cili nga sociologët ka përdorur për herë të parë termin “botë arratisëse” për të shpjeguar dinamikat e modernitetit të sotëm?

- A) Anthony Giddens
- B) George Ritzer
- C) Ulrich Beck
- D) Zygmunt Bauman

Pyetja 299.

Cili nga sociologët ka përdorur për herë të parë termin “shoqëria e rrjeteve” për të shpjeguar dinamikat e modernitetit të sotëm?

- A) Anthony Giddens
- B) George Ritzer
- C) Manuel Castells
- D) Zygmunt Bauman

Pyetja 300.

5. Cili nga sociologët e ka quajtur për herë të parë modernitetin si “projekt të papërfunduar”?

- A) Anthony Giddens
- B) Jurgen Habermas
- C) Manuel Castells
- D) Zygmunt Bauman

Pyetja 301.

6. Cili nga argumentet e poshtëshënuar është i Jurgen Habermasit?

- A) Një shoqëri është racionale kur bota e jetës pushon së ekzistuari
- B) Një shoqëri është racionale kur pushon së qeni moderne
- C) Një shoqëri është racionale kur sistemi dhe bota e jetës ndjekin logjikat e tyre
- D) Një shoqëri është racionale kur sistemi e kolonizon botën e jetës